



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË

## KOMISIONI I DHËNIES SË KONCESIONIT/ PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT

### SHTOJCË

#### PËR NDRYSHIMIN E DATËS SË ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS

Autoriteti kontraktues, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me synim nxitjen e konkurrencës mbështetur në parimet e transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, efikasitetit, trajtimit të barabartë,

duke vlerësuar situatën tepër të vështirë, të krijuar jo vetëm në vendin tonë por në mbarë botën nga gjendja epidemiologjike (sëmundja SarsCov2, virusi Covid-19), gjë e cila ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në veprimtarinë e subjekteve tregtare dhe më gjerë si dhe nisur nga kërkesa e vazhdueshme e operatorëve të ndryshëm, drejtuar AK për vështirësitë e hasura në përgatitjen si dhe dorëzimin e të gjithë dokumenteve të kërkuara sipas DPK dhe si rrjedhim me kërkesën për më tepër kohë në hartimin dhe plotësimin e tyre, vlerëson nevojën e shtyrjes së afatit të dorëzimit të ofertave të procedurës me objekt “Dhënie me koncesion/PPP Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, rehabilitim dhe transferim i segmentit rrugor Milot-Thumanë-Kashar- Luzi i Vogël- Fier. REF-64779-07-08-2020.

Kjo masë ndërmerret në mbështetje të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” të ndryshuar, ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar.

Sa më sipër:

#### **IV.3. Afati kohor për dorëzimin e ofertave:**

**ISHTE:**

Brenda dhe jo me vonë se: Data: 28/09/2020 Ora: 12:00 Oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**BËHET:**

Brenda dhe jo me vonë se: Data: 28/10/2020 Ora: 12:00 Oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**IV.4 Afati kohor për hapjen e ofertave:**

**ISHTE:**

Brenda dhe jo me vonë se: Data: 28/09/2020 Ora: 12:00 Vendi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me mjete elektronike. Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave, që paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

**BËHET:**

Brenda dhe jo me vonë se: Data: 28/10/2020 Ora: 12:00 Vendi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me mjete elektronike. Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave, që paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

**KOMISIONI I DHËNIES SË KONCESIONIT/ PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT**